

VENDIM

Nr. 33, Datë 13 / 06 / 2007

Për disa shtesa në Listën Paraprake të Pronave të Paluajtshme  
Publike  
që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë të Korçës.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, Sektori i Administrimit të Pronave Publike dhe Tokës, në bazë të Ligjit Nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" Neni 32, V.K.M. Nr. 500, datë 14.08.2001 "Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore", Ligjit Nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit". neni 8/2, dhe Ligjit Nr. 8744, datë 22/02/2001 "Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore".

VENDOSI:

1. Të shtohen në listën e pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen të transferohen në pronësi të Bashkisë Korçë, dy objektet si më poshtë vijon.
  - a) "Dyqani i Luleve" ndodhur në pallatet e Bllokut Rinia.
  - b) Markaton e Peshkut ndodhur në Pazarin e qytetit të Korçës.
2. Paraqitjen e shtesave në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike, për miratim në Këshillin e Ministrave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pronave Publike dhe Tokës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Raymonda Nase  
KRYETARI  
RAIMONDA NASE